



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 472/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje : z. Nuhi Paçarizi -Kryetar z. Blerim Dina – Referues dhe z. Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Office 1 Kosova SH.P.K.&N.T.SH. Berati dhe N.T.P. Vlora” - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik: N.T.P. “Artini” - Prishtinë, për Dy LOTET lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi i bibliotekave shkollore me libra lot I dhe Furnizimi me libra për Bibliotekën Hivzi Sylejmani lot II” me nr. prok: 19-2906-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ –Komuna Prishtinë, më datën 29.08.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Office 1 Kosova SH.P.K.&N.T.SH. Berati dhe N.T.P. Vlora” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi i bibliotekave shkollore me libra llot I dhe Furnizimi me libra për Bibliotekën Hivzi Sylejmani llot II” me nr.prok: 19-2906-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ –Komuna Prishtinë.

II. ANULOHET, vendimi i AK - Njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi i bibliotekave shkollore me libra lot I dhe Furnizimi me libra për Bibliotekën Hivzi Sylejmani lot II” me nr. Prok : 19-2906-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Komuna Prishtinë, dhe lënda kthehet në **Ri vlerësim për Lot 1 dhe 2**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Office 1 Kosova SH.P.K.&N.T.SH. Berati dhe N.T.P. Vlora” - Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 09.05.2019

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 08.07.2019

Data e njoftimit me letër standarde është bërë me dt: 15.07.2019

Data e njoftimit e vendimit të AK-së është bërë me dt: 15.07.2019

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 31.05.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 22.07.2019

Data e vendimit të AK –së, lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë: 25.07.2019.

Operatori ekonomik ankues: “Office 1 Kosova SH.P.K.&N.T.SH. Berati dhe N.T.P. Vlora” - Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me datën: 01.08.2019 me nr.472/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi i bibliotekave shkollore me libra lot I dhe Furnizimi me libra për Bibliotekën Hivzi Sylejmani lot II” me nr.prok: 19-2906-1-1-1, /AK/ – Komuna Prishtinë duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60, LPP-së dhe nenin 39, dhe nenin 41 të RrUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 08.08.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 19.08.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues: “Office 1 Kosova SH.P.K.&N.T.SH. Berati dhe N.T.P. Vlora” - Prishtinë, në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

Ju keni marrëveshje me librarin e Fatmir Xhaferit për Lot I (43 tituj) dhe për Lot II 327 tituj librash që biesh me kërkesën tonë pasi që nuk janë shtëpi botuese por librari dhe njëherit për Lot II i mungojnë 70 tituj që nuk ka marrëveshje si dhe marrëveshjen me shtëpinë botuese “Uegen” që janë tituj që nuk është e vëlosur dhe e nënshkruar nga botuesi për Lot II.

Lidhur me arsyet të OE ankues, eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, ku AK-ja, ka kërkuar që OE-të duhet të kenë “Marrëveshjen me shtëpitë botuese për furnizimin me këta lloj artikuj të librave (në marrëveshje të jënë të specifikuar titujt e librave për secilin lot)”, eksperti shqyrtues, vlerëson se për të konstatuar se a e plotëson këtë kërkesë të dosjes së tenderit duhet të bëhet verifikim me i detajuar i marrëveshjeve të dorëzuara nga OE ankues për faktin se në marrëveshje thuhet se është shtëpi botuese ndërsa vëlen të cilën e ke vendosur në fund të marrëveshjes shkruan Librari. Pra, në marrëveshjet e dorëzuara ka paqartësi.

Lidhur me këtë çështje OE ankues pretendon se AK-ja, nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë me arsyetimin se, edhe i rekomanduari për kontratë ka dorëzuar marrëveshje të cilat nuk janë shtëpi botuese, ku ndër të tjera përmend edhe marrëveshjen e nënshkruar në mes të OE Artini dhe Rilindja AG, që po ashtu në marrëveshje thuhet se është shtëpi botuese, ndërsa certifikatën e biznesit nuk thuhet se është shtëpi botuese dhe se aktiviteti primar i Rilindjes është: Ndërmjetësimi për shitjen e një shumëllojshmërie mallrash ndërsa si aktivitet sekondar e ka tregtinë me shumicë të pijeve.

Vlen të përmendet se AK-ja, në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim ka deklaruar se AK-ja, ka bërë hulumtim dhe i ka vërtetuar se i rekomanduari për kontratë i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit, mirëpo eksperti shqyrtues, sqaron se nuk asnjë dëshmi është bërë verifikim i marrëveshjeve në fjalë.

Sa i përket mungesës së titujve në marrëveshje, eksperti shqyrtues sqaron se fillimisht siç u përmend më lart duhet, që së pari të verifikohen saktë marrëveshjet dhe pastaj të jepet sqarimi për titujt e librave, për faktin se, nëse njeri nga të kontraktuarit e OE ankues apo të OE të rekomanduar për kontratë nuk janë shtëpi botuese atëherë nuk vazhdohet me tutje me vlerësim.

Eksperti shqyrtues, në fund vlerëson se pretendimet ankimore të OE ankues janë pjesërisht të qëndrueshme dhe njëherit vlerëson se AK-ja, duhet që konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së, të bëjë verifikim të marrëveshjeve të përmendura në ankesën e OE ankues.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet vendimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 23.08.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 23.08.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 29.08.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i Autoriteti Kontraktues si dhe eksperti shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z. Fetoshi deklaroj: Ne në këtë AP jemi eliminuar për te 2 Lotet për Lot 1 me arsyetimin se kemi ofruar një marrëveshje me Librarin Fatmir Xhaferi me 43 Tituj dhe për Lot 2 327 Titujsh Librash e si arsyetim është dhënë që Libraria Fatmir Xhaferi nuk është Shtëpi Botuese por është Librari ndërsa për Lot 2 që na mungojnë 70 lloje të librave dhe marrëveshje me Shtëpinë botuese UEGEN që nuk është e vulosur dhe e nënshkruar nga Botuesi. Këto arsye të eliminimit për mendimin tonë janë të paqëndrueshme për shkak se Libraria Fatmir Xhaferi është pike shpërndarëse e librave në Tiranë dhe ky fakt mund të vërtetohet Lehte nga kush do, ndërsa sa i përket Lot 2 në lidhje me marrëveshjen Autoriteti Kontraktues nuk ka ndërmarr asnjë hap për të sqaruar këtë lëshim në marrëveshjen me shtëpinë botuese UEGEN dhe asnjë hap për të sqaruar edhe titujt e Librave që Autoriteti Kontraktues pretendon që mungojnë, pra Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar dispozitat e nenit 59.2 dhe 72 në raport me ofertën tonë.

Mirëpo Autoriteti Kontraktues këto dispozita i ka përdorur në mënyrë favorizuese për OE e rekomanduar për kontratë për të cilët ka kërkuar sqarime.

Ne mendojmë se OE –te e rekomanduar për kontratë nuk i kanë plotësuar kërkesat e DT-së sepse sipër Lot 1 dhe Lot 2 kanë ofruar marrëveshje me librari e jo me shtëpi botuese e për të cilat arsyeje ne jemi eliminuar në këtë rast janë përdorur kriteret favorizuese për OE-te e rekomanduara për kontratë duke marrë parasysh marrëveshjet të cilat i kanë me libraritë ndërsa në anën tjetër nuk janë marrë parasysh

marrëveshjet që ne kemi në mënyrë të njëjtte me Libraritë, si shembull i ceku marrëveshjet për Lot 1 që OE i rekomanduar për kontratë i ka me Rilindja AG në Prishtinë e cila nuk është shtëpi Botuese Vajazan, LumaSkendo instituti i studimeve historike dhe disa të tjera që janë të cekura në ankese po ashtu edhe për Lot 2 janë të cekura në ankese marrëveshjet të cilat nuk i kanë me shtëpitë Botuese.

Ne jemi në një situatë të barabartë me OE e rekomanduar veç se ne jemi me çmime të ulëta se OE-të e rekomanduar. Kërkese e jona është nëse konsiderohet lëshim i vogël apo devijim e njëjta qeshte të konsiderohet për të gjithë ofertuesit e atë me tepër ku ne kemi çmime më të ulëta dhe të mirët në konsideratë nëni 1 dhe 6 i LPP-së. Marrëveshjet e kontestuar i kemi të nënshkruara me datë të më hershme dhe mund të dëshmojmë nëse kërkohen sqarime shtese.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Bardhaj deklaroi: Pika e parë që realisht është një pretendim që unë nuk e kam parë nuk është kontestuar Libraria Xhaferi nuk është e autorizuar për shpërndarjen e të gjitha librave në marrëveshje.

Në pikën tjetër në plotësimin e tenderit sipas nenit 72 dhe 39 të RrUOPP-së Autoriteti Kontraktues konsideron se është plotësisht i pa bazuar për arsyen e thjeshtë se dispozitat ligjore përcaktojnë qartë se mund të kërkohet plotësim ose sqarim i dokumenteve të cilat mund të vlerësojnë në mënyrë objektive se kanë ekzistuar para dorëzimit të tenderit dhe marrëveshjet e tilla realisht do të ishte kërkesë që ti themi OE-së se, se mund të besh marrëveshje si të duash dhe të dorëzosh ku të duash. Lidhur me pretendimet se OE i propozuar për kontratë ka marrëveshje të njëjta si ankuese. Në vendimin sipas asaj ankese është shkruar nga Autoriteti Kontraktues në mënyrë recidive se janë verifikuar të gjitha ata tituj dhe është konstatuar se të gjitha ato libra janë të botuara dhe janë në shitje me Emrat e Botueseve apo shtëpive botues që figurojnë në marrëveshjen e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë.

Në lidhje me ekspertizën në lidhje me nenin 72 kemi thënë që nuk pajtohemi ndërsa ajo që ne kemi verifikuar në vendimin për rishqyrtim kemi thënë se kemi verifikuar dhe ekspertiza ka mund të thotë që është verifikuar. Rilindja nuk ekziston më dhe organizata që është formuar i ka barte të gjitha të drejtat dhe ajo bënë vetëm distributimin dhe nuk shoh që ka diçka tjetër të shtoj.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Basha deklaroi: Gjate shqyrtimit të pretendimeve ankimore kam vërejtur se Autoriteti Kontraktues nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë të 2 OE pjesëmarrës për faktin se nuk ka bërë verifikimin e marrëveshjeve të OE-ve të cilët i kanë me shtëpitë Botuese në lidhje me këtë kërkesë sqaroj se përfaqësuesi i Autoriteti Kontraktues deklaroi se nuk kanë autorizim, autorizimi nuk është në dt. dhe siç e përmend edhe më lart OE është marrëveshje me shtëpitë e botuese arsye për të cilët edhe është eliminuar OE ankues i cili njëherët ka pretendim me oferte e OE të rekomanduar për kontratë, Autoriteti Kontraktues pretendon që ka bërë verifikimin e Ofertës se OE të

rekomanduar për kontrate mirëpo ne uebfaqen e ARBK-se OE Rilindja i cili i rekomanduar ka marrëveshje si Aktivitet Primar dhe sekondar e ka te regjistruar tregtinë me shumice te pijeve dhe aktivitetin e ndërmjetësimit te shitjes se mallrave prandaj ne fund kam konstatuar pa verifikimin e marrëveshjeve te të 2 OE-ve nuk duhet te përfundoj aktiviteti.

Përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë qe ankesa jone te aprovohet dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: Kërkojmë qe ankesa e OE-se te refuzohet si te pa bazuar te të mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues te prokurimit konstaton se Kemi te bëjmë vetëm me nje pretendim ankimor te OE ankues vetëm me arsyen e eliminimit te OE ankues: “Office 1 Kosova SH.P.K.&N.T.SH. Berati dhe N.T.P. Vlora” - Prishtinë, me arsyetimin se: Ju keni marrëveshje me librarin e Fatmir Xhaferit për Lot I (43 tituj) dhe për Lot II 327 tituj librash qe bie ndesh me kërkesën ton pasi qe nuk janë shtëpi botuese por librari dhe njëherit për Lot II i mungojnë 70 tituj qe nuk ka marrëveshje si dhe marrëveshjen me shtëpinë botuese “Uegen” qe janë tituj nuk është e vulosur dhe e nënshkruar nga botuesi për Lot II.

Lidhur me arsyet te OE ankues, ku AK-ja, ka kërkuar qe OE-te duhet te kenë “Marrëveshjen me shtëpitë botuese për furnizimin me këta lloj artikuj te librave (ne marrëveshje te jene te specifikuar titujt e librave për secilin lot)”, Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues te prokurimit konstaton se për te konstatuar se a e plotëson këtë kërkesë te dosjes se tenderit duhet te behet verifikim me i detajuar i marrëveshjeve te dorëzuara nga OE ankues për faktin se ne marrëveshje thuhet se është shtëpi botuese ndërsa vulën te cilën e ke vendosur ne fund te marrëveshjes shkruan Librari.

Lidhur me këtë çështje OE ankues pretendon se AK-ja, nuk i ka trajtuar ne mënyrë te barabartë me arsyetimin se, edhe i rekomanduari për kontratë ka dorëzuar marrëveshje te cilat nuk janë shtëpi botuese, ku nder te tjera përmend edhe marrëveshjen e nënshkruar ne mes te OE Artini dhe Rilindja AG, qe po ashtu ne marrëveshje thuhet se është shtëpi botuese, ndërsa certifikatën e biznesit nuk thuhet se është shtëpi botuese dhe se aktiviteti primar i Rilindjes është: Ndërmjetësimi për shitjen e një shumëllojshmërie mallrash ndërsa si aktivitet sekondar e ka tregtinë me shumice te pijeve.

Vlen te përmendet se AK-ja, ne përgjigje te kërkesës për rishqyrtim ka deklaruar se AK-ja, ka bere hulumtim dhe i ka vërtetuar se i rekomanduari për kontratë i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit, mirëpo

eksperti shqyrtues, ka sqaruar Panelin shqyrtues se nuk asnjë dëshmi është bere verifikim i marrëveshjeve ne fjalë, Paneli shqyrtues nuk e konteston se OE i rekomanduar nuk i plotëson kërkesat e AK-se por kërkon nga AK qe te respektohet neni 7 i LPP-se duke i trajtuar ne mënyrë te barabarte te gjithë OE-të pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi Paçarizi



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna Prishtinë

1x1 OE“Office 1 Kosova SH.P.K.&N.T.SH. Berati dhe N.T.P. Vlora” - Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.